# DËSHMI ARKIVI

**A-472257**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I dënuar për vrasjen e gruas, 49-vjeçari gjendet i pajetë në burgun e Reçit - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/i-denuar-per-vrasjen-e-gruas-49-vjecari-gjendet-i-pajete-ne-burgun-e-recit/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 17:43:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 17:38:59 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2b33fd8ecbc65695487205069746b21d08bccf2888f66c1af896f9005bb611c3` |
| TEKSTI | `1777dbb2c177bc9aa210be25805167f8ddc086577eb94e4939365edb3c46dddd` |
| PAMJA | `c39f59d01ae4bde63ac7430fd741b25fa5ea1d900a31bb7cad0124cdc5a8c6f5` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8803cbec461e638cb1caf32855bbbede38b9ea7ca8f667ab8939e4e50388d383` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f1d82a646bd703b2c3db300ad07fe31d63113d7410715c948367b3c04c7e5621` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8803cbec461e638cb1caf32855bbbede38b9ea7ca8f667ab8939e4e50388d383`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | VENDI

# I dënuar për vrasjen e gruas, 49-vjeçari gjendet i pajetë në burgun e Reçit

26 Shtator 2026 | 19:38

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Një 49-vjeçar që vuante dënimin në burgun e Reçit është gjetur i pajetë në ambientet e institucionit. Viktima është identifikuar si Agron Llapushi, i dënuar për vrasjen e bashkëshortes së tij në vitin 2015.

Sipas të dhënave paraprake, Llapushi është gjetur i varur në ambientet e dusheve. Dyshohet se bëhet fjalë për vetëvrasje, ndërsa rrethanat e plota të ngjarjes janë duke u verifikuar nga autoritetet.

Llapushi ishte nga zona e Gramshit dhe po vuante një dënim prej 24 vitesh e 4 muaj burgim. Ai ishte arrestuar në prill të vitit 2015, pas vrasjes së bashkëshortes së tij, Alketa Llapushi.

Ngjarja për të cilën u dënua kishte ndodhur në Gramsh, ku 39-vjeçari vrau bashkëshorten pasi ishte kthyer nga emigrimi në Greqi.

Pas krimit, ai u dorëzua në polici dhe pranoi autorësinë. Në atë kohë, Prokuroria për Krime të Rënda kishte kërkuar burgim të përjetshëm, por gjykata vendosi dënimin me 24 vite e 4 muaj burgim për veprën penale “Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”.

Sipas të dhënave të siguruara, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, 49-vjeçari kishte pasur kontakte shumë të rralla me familjarët.

Ai rezulton të ketë marrë vetëm dy vizita, në vitet 2023 dhe 2025. Llapushi dhe bashkëshortja e tij ishin prindër të dy fëmijëve, të cilët në momentin e krimit ishin ende të mitur.

Hetimet vijojnë për të përcaktuar dinamikën e ngjarjes dhe rrethanat që çuan në vdekjen e të dënuarit.

**Shiko në:**

**LAJMI I FUNDIT**

19:24 **Dita e 119-të e protestës, qytetarët mblidhen para Kryeministrisë**

19:21 **Lavrov akuza të forta në OKB: Evropa po bllokon bisedimet e paqes me Ukrainën, Perëndimi po shkon drejt rrugës pa krye**

19:10 **Përfshihet nga flakët autobusi në hyrje të Tunelit të Krrabës, digjet plotësisht (VIDEO)**

19:07 **11 të vrarë në Pakistan nga një sulm kamikaz në pikën e kontrollit (VIDEO)**

18:47 **Presidenti i Manchester City-t letrë tifozëve pas vendimit të Premier League: Jemi të pafajshëm, do të dalim fitimtarë**

18:27 **Deklarata e papritur e Trump! SHBA dhe Kuba drejt marrëveshjes, shmanget opsioni ushtarak**

TESTIM

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

**Dita e 119-të e protestës, qytetarët mblidhen para Kryeministrisë**

Qytetarë dhe aktivistë kanë dalë këtë të shtunë në protestën e radhës e cila hyri në ditën e saj të 119-të. Si çdo pasdite, pas...

19:24 | 26/09/2026

AKTUALITET | VENDI

**Përfshihet nga flakët autobusi në hyrje të Tunelit të Krrabës, digjet plotësisht (VIDEO)**

Një autobus është përfshirë nga flakët dhe është djegur plotësisht në afërsi të hyrjes së Tunelit të Krrabës. Sipas raportimeve, nga zjarri autobusi është shkrumbuar,...

19:10 | 26/09/2026

AKTUALITET | VENDI

**Trafikantët përplasin makinat e policisë në Gramsh dhe braktisin 15 emigrantë në Lozhan, në kërkim autorët**

Dy automjete "Audi Q7" nuk i'u bindën urdhrit të policisë për të ndaluar, duke përplasur patrullat në postbllok dhe u larguan me shpejtësi. Operacioni u...

17:52 | 26/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.